



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Datë: 07.03.2024

Me kërkesë të Sektorit për punë të Kuvendit Komunal të datës 29 shkurt/ 2024, për takimin e rradhës së Komitetit për Politikë e Financa, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim hartoi këtë:

INFORMATË

MBI PREGADITJET NDAJ EMERGJENCAVE NË KOMUNËN E GJAKOVËS

HYRJE

Qëllimi i kësaj Informatë, është që të bëhet përmbledhja dhe pasqyrimi i punëve, detyrave dhe aktiviteteve të realizuara në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, përmes së cilës paraqitet volumni i punës me statistikat e veqanta, analizat e punës dhe elaborimet mbi ecurinë e punëve dhe detyrave për të cilat është kompetente kjo Drejtori.

Pikësynimet tona gjatë realizimit të detyrave dhe përgjigjësive kanë qenë në aktivizimin e potencialit të Drejtorisë në marrjen e masave preventive të mbrojtjes dhe shpëtimit, në ofrimin e drejtpërdrejtë të ndihmës në parandalimin apo në zvogëlimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera të mundshme.

Mbështetur Statutin e Komunës, në “Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera” nr. 04/L-027, të “Ligjit për Mbrojtje nga Zjarri” nr. 04/L-012, dhe dokumentëve tjerë strategjik si Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave dhe Planit të Reagimit Komunal dhe Kombëtar, të cilat përkufizojnë kompetencat e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në fushën e menaxhimit dhe koordinimit të situatave emergjente në komunë, kjo drejtori gjatë vitit 2023 ka realizuar një mori aktivitete konform njësive të saj organizative.

1. Aktivitetet kryesore të Drejtorisë

- Mbikqyrja e zbatimit të dispozitave ligjore dhe akteve tjera normative që rregullojnë funksionimin e sistemit të emergjencave civile në komunë;
- Njoftimi, paralajmërimi dhe alarmimi i qytetarëve për rreziqet e pashmangshme dhe dhënja e udhëzimeve për parandalimin dhe zvogëlimin e pasojave eventuale nga fatkeqësitë natyrore;
- Identifikimi, monitorimi dhe hulumtimi permanent i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi tjera që kërcënojnë komunën e Gjakovës;
- Reagimi ndaj situatave emergjente në komunë .
- Organizimi i gatishmërisë emergjente, krijimi dhe mirëmbajtja e formave tjera të gatishmërisë për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
- Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
- Trajnimi dhe aftësimi profesional për detyrat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;
- Koordinimi me strukturat e nivelit lokal, ndërkomunal dhe qendror në funksion të zbatimit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësit natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
- Hartimi dhe azhurnimi i vlerësimit të rreziqeve dhe planeve operative për mbrojtje nga fatkeqësit natyrore dhe fatkeqësit tjera;
- Programimi dhe planifikimi i mjeteve buxhetore dhe logjistike për realizimin i projekteve për parandalimin e rreziqeve, gatishmëri, për reagim në fatkeqësi dhe sanim të gjendjes pas fatkeqësisë;

2. Qendra Operative Emergjente-112



Kjo njësi organizative ka bërë pranimin, selektimin, distribuimin dhe shkëmbimin reciprok ditorë i informatave për të gjitha llojet e rreziqeve për jetën e qytetarëve dhe të të mirave materiale me qëllim të marrjes së masave mbrojtëse në parandalimin dhe eliminimin e pasojave të mundshme.

Gjatë vitit 2023 janë pranuar gjithsejtë **18.882** thirrje nga qytetarët dhe subjektet tjera juridike, ndërsa janë menaxhuar **404** raste emergjente duke u koordinuar me strukturat reaguese si: Policia e Kosovës, Zjarrfikësit, FSK, urgjencën medicinale të QKMF dhe Spitalit Rajonal, Kryqin e Kuq, , si dhe me Kompanit Publike tjera që operojnë në komunë KRU Gjakova, KEDS, KRM “Çabрати”, OIQ ,etj.

Vlenë për tu theksuar se gjatë vitit paraprak Qendra 112 është plotësuar me 4 zyrtar tjerë për telefoni që aktualisht përbëjnë gjithsejtë 8 veta, duke arritur kështu kriterin operacional, kështu që nga fillimi i këtij viti ajo funksionon pandërprerë 24/7. Me këtë riorganizim, tani më kjo Qendër i plotëson kushtet e avancimit të saj në Qendër Operative Emergjente Rajonale-112 e cila do të jetë strukturë organizative e Agjensionit të Menaxhimit Emergjent në kuadër të MPB-së, ngjajshëm si komunat tjera të mëdha në Kosovë. Në vazhdimësi janë dërguar shkresa në këtë adresë për avancimin e saj në nivel rajonal, qoft edhe nga autoriteti më i lartë ekzekutiv në komunë, por deri më tani nuk kemi pranuar asnjë përgjigje zyrtare.

3. Preventiva dhe reagimi emergjent

1. **Vërshimet:** Menaxhimi i situatës emergjente të shkaktuar nga reshjet shiut në janar/2023 me ç’ rast janë vërshuar disa rrugë në zonat urbane të qytetit si: “Mazllom Myezini”, “Bajram Curri”, “Skender Shehu”, “Bujar Roka”-tranzimi i ri, përmbytja e rrugës magjistrale Gjakovë-Deçan në Osek Hylë,. si dhe të disa bodrumeve të shtëpive si raste të izoluar.






2. **Erërat e forta:** Vlerësimi i gjendjes së shkaktuar nga erërat e forta dhe konstatimi i dëmeve të shkaktuara ne dt.26.02.2023, sidomos në rajonin e Rekës së Keqe, më saktësisht në fshatin Duzhnje dhe Popoc (shpluarje kulmeve dhe disa shtyllave elektrike) dhe disa pemë, konstruksione metalike dhe pullaze të shtëpive rrethë stadiumit të “Vëllaznimit”.



3. **Rrëshqitjet e tokës:** Vlerësimi i situatës në teren të shkaktuar nga rrëshqitjet e tokës gjatë janarit dhe shkurtit/2023 dhe dhënja e rekomandimeve palëve të rrezikuara për parandalimin e mëtejme të tokës. Janë evidentuar rastet në rrugën “Ismail Qemali” në afërsi të urës së Islam Begut, pastaj në rr. “Shaban Golaj” –“Med-Care” Sh.p.k., pastaj në fshatin Zhdrellë, Ramoc, Botush, Pjetërshan, Ujzë, Gërgoc dhe Muhadër.





4. **Objekte me rrezikshmëri:** Identifikimi i objekteve të vjetra me rrezikshmërin (3 raste) dhe iniciimi i procedurave në organet kompetente për trajtimin e rastit me qëllim të shmangjes së rrezikut për banorët dhe kalimtarët e rastit.



5. **Intervenime preventive:** Realizimi i punimeve emergjente në pastrimin e disa segmenteve të në shtratin e lumit “Llukac” dhe të kanaleve të ujit në tri lokacione. Këto aktivitete janë ndërmarr në kuadër të masave preventive për parandalimin eventual të vërshimeve apo zbutjen e pasojave të mundshme ;

5.1. Rruga “Fehmi Agani”, lumi “Llukac”



5.2. Kanali i ujërave atmosferik në Dardani rr. “Dëshmorët e Dujakës”



5.3. Kanali i ujërave atmosferik në Brekoc te varrezat e qytetit



6. Mbrojtja nga zjarri



Shërbimi zjarrfikës gjatë vitit paraprak ka realizuar gjithsejtë 683 intervenime. Numri më i madh tyre rrethë 500 raste kanë të bëjnë zjarre, por duhet shtuar se përveç se në zjarre zjarrfikësit janë të obliguar të intervenojnë edhe në raste të vërshimeve, në aksidente komunikacioni, intervenime teknike dhe të një game të gjërë të shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën për qytetarët, institucionet, bizneset, etj.

Përkundër numrit të madhë të intervenimeve situata me zjarre ka qenë përgjithësisht stabile ku kryesisht janë ballafaquar në shuarjen e zjarreve në sipërfaqet fushore **245** ha (dmth. në kullosa, barishte, shkurre, tokë bujësore, etj), e në sipërfaqe pyjore dukshëm më pak **62** ha.

Gjatë vitit 2023 kemi evidentuar 3 humbje jete, duke asistuar në 2 raste të tërheqjes së trupave të pa jetë nga veturat në aksidente komunikacioni dhe 1 personi të mbytur në lumin Dri.

Statistika vjetore e intervenimeve

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe int.tjera janar-dhjetor 2023														
2023	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Të rejsh	Të lënduar			Të vdekur			Githsejt
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot	
Janar	50	17	11	2		20			1	1				50
Shkurt	35	31	3	1										35
Mars	29	18	7	3			1		1	1				29
Prill	17	7	6	3			1							17
Maj	26	14	6	6										26
Qershor	47	18	14	15								1		47
Korrik	46	29	14	2	1				2	2		1		46
Gusht	115	101	7	5	2				5	5				115
Shtator	197	173	5	16	1		2		4	4		1	1	197
Tetor	76	61	8	5	1		1		3	3				76
Nëntor	18	10	7		1				9	9				18
Dhjetor	27	16	11											27
Gjithsejtë	683	495	99	58	6	20	5	0	25	25	0	3	1	683

7. Buxheti dhe mbështetja logjistike

Buxheti i Drejtorisë për v. 2023 është menaxhuar në keto linja dhe shpenzueshmëria e tij ka qenë pothuaj se 100 % .

Planifikimi i buxhetit dhe shpenzueshmëria për v.2023


#	Gjithsejtë/€	Paga dhe mëditje/€	Investime kapitale/€	Mallëra dhe Shërbime/€	Shpenzime komunale/€
	755,000.00	405,000,00	250,000.00	80,000.00	20,000.00

- Borxhet e bartura në v. 2024 kanë qenë gjithsejtë 5.434,16 € prej të cilave 4.452,52 € në mallëra-shërbime dhe 981,16 € shpenzime komunale. Këto borxhe kanë qenë reale dhe të pashmangshme si pasojë e shpenzimeve të krjuara në dhjetor/2023. Pothuaj se në asnjë pozicion buxhetor nuk kemi pas tepriçë të mjeteve, që nënkupton se planifikimi dhe dinamika e shpenzimeve nga ana e Drejtorisë kanë qenë reale dhe e balancuar.

- Është më rëndësi të potencohet fakti se që nga përfundimi i luftës së v.1999 Shërbimi Zjarrfikës/Drejtoria për herë të parë është paisur me dy automjete të reja me kilometrazh zero nga linja - investime kapitale. Fjala është për furnizim me një autocistern zjarrfikëse me depozitë të lartë të ujit 8.500 lit/ujë në vlerë 200,000.00 € dhe të një automjeti tereni (i llojit xhip) në vlerë 50,000.00 €. Me këto blerje pak a shumë është ngritë niveli i gadishmërisë reaguese si përgjigje ndaj situata emergjente, pasi që dihet mirëfilli se i gjithë kontigjenti janë automjete të trashëguara nga ish sistemi dhe donacione nga shtete mike dhe shoqata të ndryshme. Shumica e automjeteve zjarrfikëse janë mjaftë të vjetra dhe të amortizuara, ndaj është kërkesë imediate e Drejtorisë që me Planifikimet ardhshme buxhetore të bëhet ripërtëritja dhe zëvendësimi i tyre sistematik me automjete të reja.
- Mjete buxhetore të mallëra-shërbime (80,000.00 €) kryesisht janë shpenzuar për derivate mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve (aktualisht 13 automjete funksionale), regjistrimin e automjeteve, intervenime emergjente, naftë për ngrohje, në furnizimin me mjete dhe pasije për shuarjen e zjarrit, mirëmbajtjen e ndërtesave, garazhave etj.



- **Furnizimi me paisje:** Njësia e Zjarrfikësve pothuaj gjatë 3 viteve të fundit, poashtu edhe gjatë vitit 2023 ka bërë furnizimin me mjete dhe pasije për shuarjen e zjarrit, por që kësaj rradhe vlera e tenderit ka qenë dukshëm më e vogël (10,000 €) për shkak mundësive reale financiare të drejtorisë.



- Përmes aktivitetit të prokurimit është bërë furnizimi me goma dimëri për 4 automjete të rënda zjarrfikëse dhe për 1 automjet tereni.

Donacion: Për herë të dytë Shërbimi Zjarrfikës i Gjakovës ka pranuar donacion në mjete dhe paisje për shuarje të zjarrit dhe kërkim-shpëtim. Kjo është mundësuar nga Shoqata shqiptare-zvicërrane “Shoqëria” në bashkëpunim me Brigadën e Zjarrfikësve të kantonit të Sourse.



&

Me projeksionin buxhetor për v. 2024, pozicioni mallëra-shërbime do të ketë një ngritje prej 12 % ose 90,000.00 €, duke e konsideruar këtë si një trendë pozitiv progresiv në përmbushjen e nevojave të kësaj drejtorie, edhe pse realisht kërkesat në këtë drejtim janë dukshëm më të mëdha.

Për shkak të limiteve buxhetore, në v. 2024 është planifikuar vetëm 1 aktivitet prokurimi, me ç'rast është paraparë furnizimi i zjarrfikësve me uniforma dhe për këtë qëllim janë ndarë 25.000,00 nga pozicioni mallëra dhe shërbime. Pjesa tjetër e mbetur e buxhetit planifikohet të shpenzohet për mbajtjen e nivelit të domosdoshëm funksional-operativ.

8. Trajnimet dhe koordinimi me strukturat e sigurisë

- Trajnim i organizuar nga UNDP dhe Ministria e Kulturës për “Vlerësimin e Rreziqeve në Objektet e Trashëgëmisë Kulturore”

- Pjesmarrja e 2 zyrtarëve të Drejtorisë dhe 2 pjestarëve të Preventivës dhe Hulumtimit të Zjarrit në Programin “**Edukimi për Siguri**” të organizuar nga Ministria e Mbrojtjes në koordinim me Agjencionin e Menaxhimit të Emergjencave dhe FSK-në. Ky program është mbajtur në muajin qershor/2023 në Prishtinë, ka qenë 3 javor dhe qëllimi i tij ishte certifikimi i tyre për trajnerit si kuadro që do të organizojnë ushtrime me nxënësit e shkollave të mesme të Komunës së Gjakovës.

- Pjesmarrja në Punëtorin e organizuar UNDP në bashkëpunim me Agjencionin e Menaxhimit Emergjent/MBP dhe Kryqin e Kuq të Kosovës me fokusin “Vlerësimi i dëmeve pas fatkeqësisë”;

- Në kuadër të bashkëpunimit dhe partneritetit me strukturat e sigurisë janë mbajtur disa takime me përfaqësuesit e KFOR-it italian dhe turk, të Policisë së Kosovës dhe Strukturat e Forcës së Sigurisë, gjithnjë me qëllim të koordinimit të veprimeve në situata të rënduara emergjente.

- Takime të rregullta me Zyrtarët e Policisë së Kosovës dhe FSK-së cilat janë mbajtur individualisht si dhe në takimet e rregullta në kuadrin të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSb)



9. Punët dhe detyrat tjera teknike administrative

- Hartimi i planeve dhe raporteve mujore periodike dhe vjetore të Drejtorisë;
- Vlerësime, konstatime, analiza dhe statistika dhe shkëmbimi i tyre me strukturat e reaguesve të parë në komunë dhe atyre të dytë të nivelit qendror, e sidomos me ato që janë përgjegjëse për menaxhimin e emergjencave dhe të mbrojtjes dhe sigurisë.
- Inicimi i procedurave tenderuese për tenderët: “Furnizimi me autocisternë zjarrfikëse” “Furnizimi me xhip tereni”, “Intervenime Emergjente”, “Furnizimi me goma për automjetet zjarrfikëse” dhe “Furnizimi me mjete dhe paisje për shuarjen e zjarrit”;
- Pjesmarrja në seminarin e organizuar nga USAID “Tenderët ekonomikisht më të favorshëm”;
- Pjesmarrja në hartimin e Draftit final të “Planit PKVEK- për eficiencë”;
- Menaxhimi i performancës së Drejtorisë dhe përcaktimi i mënyrës së ngarkimit të dokumentacionit në Web-faqen e Ministrisë së Pushtetit Lokal;
- Me kërkesë të Komisionit Qendror për Vlerësimin e dëmeve është proceduar gjithë dokumentacioni i rrethë 200 ekonomive familjare me qëllim të kompensimit të dëmeve. Kompensimi është bërë direct nga Ministria e Financave dhe Transfereve tremujorin e tretë të këtij viti me 90 % të vlerës së vlerësuar të demit nga ana e Komisioni Komunal.

Arhiva: Gjatë kësaj periudhe raportuese, kjo Drejtori ka pranuar dhe trajtuar gjithsejtë 86 lëndë, prej të cilave 78 janë miratuar, 6 janë transferuar tek drejtoritë përkatëse dhe 2 lëndë janë refuzuar.

JU FALEMINDERIT

